

CA MPC janar 2025 ALB

1. Lutuni – “Bekoni ata që ju mallkojnë, lutuni për ata që ju keqtrajtojnë” (Luka 6:28). E pamundur ta bëjmë këtë me forcat tona. Por Jezusi në ne mund të na ndryshojë në njerëz të paqes.

2. Im – “Zoti është bariu im” (Ps 23:1a). Fjala "im" bën të gjithë ndryshimin. Kjo është arsyeja pse besimi im te Zoti rritet. Kështu ai mund ta udhëheqë jetën time në një rrugë të mirë dhe të kujdeset për mua. Kjo është arsyeja që unë e ndjek Atë me kënaqësi.

3. Veprat e mira – “Ne në fakt jemi vepra e tij, e krijuar në Krishtin Jezus për veprat e mira që Perëndia përgatiti që më parë, që ne të ecim në to” (Efesianëve 2:10). Perëndia na çon çdo ditë në rrethanat që Ai ka përgatitur për ne. Le të jemi të vëmendshëm dhe të bëjmë punën e mirë që na pret.

4. Paraja – “Sepse lakmia për para është rrënja e gjithë të këqijave dhe, duke e lakmuar atë fort, disa u larguan nga besimi dhe e depërtuan veten e tyre në shumë dhembje” (1 Timoteut 6:10). Ne jemi vetëm administratorë të pasurive që Perëndia na ka besuar. Prandaj, njeri, kujdes prioritetet e tua!

5. Martesa – “Ju burra, gjithashtu, jetoni me gratë tuaja me urtësi, duke e çmuar gruan si një enë më delikate dhe e nderoni sepse janë bashkëtrashëgimtare me ju të hirit të jetës, që të mos pengohen lutjet tuaja.” (1 Pjetrit 3:7). O Burrë, pranoje rolin tënd të dhënë nga Zoti dhe bekoje familjen duke përmbushur detyrën tënde priftërore.

6. Dhurata – Është bukur të marrësh dhurata. Disa njerëz reagojnë ndryshe kur marrin një dhuratë. Të tjerë madje refuzojnë atë që ofrohet. Gjoni 3:16 thotë se Perëndia, në dashurinë e tij, dha dhuratën më të madhe dhe më të mirë, Birin e Tij të vetëm, në mënyrë që bota të shpëtohet nëpërmjet tij. Pranojeni Jezusin si Shpëtimtarin tuaj dhe shijoni jetën e përhershme me të!

7. Për jetën – Kultura e botës së sotme ka përhapur shumë ide për martesën, duke relativizuar dhe banalizuar marrëdhëniet bashkëshortore. Bibla mëson se Perëndia bashkon në martesë dhe se martesë është një marrëdhënie e përhershme për jetën (1 Korintasve 7:39). O burrë, me ndihmën e Zotit martesë juaj mund të pasqyrojë gëzimin e partneritetit të vërtetë.

8. Dishepullimi – Në takimin e fundit me dishepujt e tij, Jezusi i urdhëroi ata të bëjnë dishepuj, me porosinë: “Dhe duke i mësuar të zbatojnë të gjitha gjërat që unë ju kam urdhëruar” (Mateu 28:20). Bëhuni një baba që i inkurajon fëmijët e tij të ndjekin Zotin përmes jetës së tij shembullore.

9. Qëllimi – “Më nxori jashtë një grope shkatërrimi, nga balta e moçalit, i vendosi këmbët e mia mbi një shkëmb dhe i ka bërë të qëndrueshme hapat e mia.” (Psalmi 40:2). Një jetë pa Jezusin është e çrregullt, e paqëndrueshme dhe e pistë si një gropë balte. Prandaj, besoni Jezusin! Ai do t'ju japë jetën, shpresën dhe një qëllim të qartë. Me Të, ju ecni përpara i sigurt dhe i vendosur, si të ecni mbi një shkëmb!

10. Mençuria – Investimi i sigurt, kursimi për periudha të vështira dhe shpenzimi me mençuri janë parime biblike për një jetë të shëndetshme financiare. “Në shtëpinë e të urtit ka një thesar të çmuar dhe vaj, por njeriu budalla i bën të gjitha rrush e kumbulla” (Fjalët e Urta 21:20) Nuk është të pasurit shumë, as të pasurit pak, por përdorimi i mençur i të mirave dhe vlerave që zbulon mençurinë e vërtetë!

11. Planet – Fillimi i një viti të ri sjell mundësinë e rishikimit të objektivave, hartimit të planeve dhe përcaktimit të asaj që dëshironi të arrini në muajt e ardhshëm. Mos harroni se plani dhe mendimet e Zotit janë gjithmonë më të larta se tonat. “Ka shumë plane në zemrën e njeriut, por vetëm plani i Zotit do të mbetet i pandryshuar.” (Fjalët e Urta 19:21).

12. I shfajsuar – “I dashur Zot, jeta duket kaq e padrejtë. Kudo që kthehem shoh padrejtësi. Pastaj kthehem te Ti dhe shikoj kryqin. Aty, Ti, i drejti vuajte për mua të padrejtin, Ti i drejti për të padrejtët. U bërë shfajësuesi ynë. Unë jam i shfajësuar nëpërmjet Krishtit. Unë tani jam drejtësia e Perëndisë në Krishtin. Halleluja!” (2 Korintasve 5:21).

13. Ati i Përjetshëm – “Zoti i Plotfuqishëm, kjo botë e vjetër dhe gjithçka në të po shembet. Asgjë nuk duket se do të zgjasë. Është aq zhgënjyese sa që ndonjëherë më vjen të dorëzohem. Dhe pastaj shikoj tek Ty. Ti je Zoti i përjetshëm. Faleminderit që më mundësove të duroj sprovat si një ushtar i mirë i Krishtit!” (Isaia 40:28).

14 I Gjithëdijshëm – “I dashur Zot, nuk duket se e di kurrë atë që duhet të di kur duhet ta di. Vetëm Ti, o Zot, je i Gjithëdijshëm. Prandaj, heq dorë nga përpjekjet për t'i kuptuar gjërat. Unë i drejtohem Krishtit, i cili është njohuria, mençuria dhe kuptueshmëria ime. Unë dorëzohem para Teje që të më bësh të njohur atë që duhet të di (Veprat 15:18).

15. Thesari – “Faleminderit, Zot, për thesarin e mahnitshëm të pranisë Tënde të brenda meje! Gjithë dituria dhe urtësia janë të përfshira në Ty. Unë të pranoj Ty si burimin e dijes dhe urtësisë sime. Prandaj, kam besim te Ti që të më bësh të njohur atë që duhet të di, kur duhet ta di” (Kolosianët 2:2.3).

16. Zoti është i mirë – “Zot Jezus, faleminderit që na tregove se Perëndia është i mirë, gjithmonë duke bërë mirë. Përmes besimit, Ti më ke dhënë jetën e re, jetën Tënde. Faleminderit! Unë vetë e kam përjetuar mirësinë tënde. Më nxit tani t'u bëj mirë të tjerëve, ashtu siç më bërë mirë mua” (Psalmi 119:68).

17. Kokëfortësia – “Një njeri që mbetet kokëfortë pas shumë qortimesh, do të shkatërrohet papritmas pa asnjë ilaç” (Fjalët e Urta 29:1). O burrë, ki kujdes që mos t'i rezistosh veprës së Frymës së Shenjtë në jetën tënde. Ai dëshiron të të udhëheqë drejt pendimit. Mos jini kokëfortë, përkundrazi nënshtrohuni në bindje ndaj Zotit. Ai u jep hir të përlurve.

18. Thesari i Fshehur – “Mbretëria e Perëndisë është si një thesar i fshehur në një arë... një njeri e gjeti... në gëzimin e tij shkoi dhe shiti gjithçka kishte dhe bleu atë arë” (Mateu 13:44). Nëse keni gjetur Jezusin, keni gjetur thesarin më të madh. Ai mund të përmbushë dëshirat tuaja më të mëdha. Paguani çmimin! Jetoni vetëm për Të dhe Mbretërinë e Tij!

19. Zemërngurtësia – “Sot, nëse e dëgjoni zërin e tij, mos e ngurtësoni zemrën tuaj” (Hebrenjve 3:15). Vullneti i lirë është dhurata e Zotit për njerëzimin. Ne mund të bëjmë zgjedhjet tona! Askush nuk mund t'i pengojë zemrat tona të dëgjojnë, por vetëm mëkati dhe ne vetë. Prandaj, jini të vëmendshëm dhe zbutuni nëse dëgjoni thirrjen e Zotit. Ai dëshiron t'ju bekojë dhe t'ju udhëheqë.

20. Përgjigje e butë – “Përgjigjja e butë largon zemërimin, por një fjalë e ashpër ngjall zemërim” (Fjalët e Urta 15:1). Stresi, zhgënjimi dhe mungesa e vetëkontrollit çojnë lehtësisht në konfrontim dhe fjalë të ashpra. Njihni veten dhe stërvitni mendjen dhe emocionet tuaja ndërsa i nënshtrooni vullnetin tuaj në bindje ndaj Krishtit, i cili është zemërbutë dhe i përlulur në zemër.

21. Krenaria – “Gjithashtu ju, të rinjtë, nënshtrojeni pleqve. Po, nënshtrojeni të gjithë njëri-tjetrit dhe vishuni me përlulje, sepse Perëndia i kundërshton krenarët, por u jep hir të përlulurve” (1 Pjetrit 5:5-6). Jini të vendosur të jetoni sipas standardit të Perëndisë, edhe nëse është kundërkulturë. Ajo që ka rëndësi në fund është ajo që Zoti shpërblen.

22. Izolimi – “Ai që ndahet kërkon dëshirën e vet; ai grindet kundër çdo diturie të shëndoshë” (Fjalët e Urta 18:1). Nëse jeni zhgënjyer nga të tjerët, rrezikoni të izoloheni. Lejo që Zoti ta ndryshojë atë. Ai na ka krijuar për marrëdhënie me Të dhe të tjerët. Jini të gatshëm të falni dhe të doni Zotin dhe të afërmit tuaj.

23. Mirësia – “Njeriu i mirë nxjerr të mirën nga thesari i zemrës së tij” (Luka 6:45). Ne kemi nevojë të lindim përsëri dhe të marrim zemrën e re për të cilën flet Bibla. O burrë, lejo ndryshimin! Lejoni që Jezui Krishti të ndryshojë zemrën tuaj dhe të filloni të jetoni nëpërmjet besimit në Të. Atëherë do ta bekoni botën tuaj me mirësi.

24. Vetë-vullneti – “Nëse dikush dëshiron të më ndjekë, le ta mohojë vetveten, ta marrë çdo ditë kryqin e tij dhe të më ndjekë” (Luka 9:23). Dishepullimi është dorëzimi i përditshëm i vullnetit të Jezui Krishti. Kryqi na kujton se natyra jonë e vjetër vdiq me Krishtin. Ai na mundëson tani ta ndjekim Atë dhe të jetojmë si fëmijë të Perëndisë.

25. Pushoni – “Ejani tek Unë, të gjithë të lodhur dhe të rënduar, dhe Unë do t'ju jap prehje. Merrni mbi vete zgjedhjen time dhe mësoni nga Unë, sepse Unë jam zemërbutë dhe i përlulur nga zemra dhe ju do të gjeni prehje për shpirtat tuaj. Sepse zgjedha ime është e ëmbël dhe barra ime është e lehtë” (Mateu 11:28-30). Thuaj "po" ofertës së Zotit, mëso prej Tij dhe përjeto prehjen e Tij.

26. Përfitimi – “Sepse çfarë dobie ka njeriu të fitojë gjithë botën dhe të humbasë shpirtin e tij” (Marku 8:36)? Ne burrat e lidhim lehtësisht suksesin me fitimin afat shkurtër. Por njerëzit e mençur mendojnë afatgjatë! Koha jonë mbi planetin Tokë është e kufizuar. Ajo që ne mund të fitojmë në këtë botë është jetëshkurtër. Zoti na thërret të rishqyrtojmë përparësitë tona dhe të investojmë për përfitim të përjetshëm.

27. I tejkaluar në numër – “Sepse porta është e vogël dhe e ngushtë udha që të çon në jetë, dhe pak janë ata që e gjejnë” (Mateu 7:14). Zoti e do botën, edhe pse pak e duan Atë. Ai i fton të gjithë të vijnë te Jezusi, por vetëm një numër i vogël i dorëzohet me besim Shpëtimtarit. Turma nuk do të ketë kurrë të drejtë. Jini të gatshëm të jeni të tejkaluar në numër me Perëndinë.

28. Rebelimi – “Prandaj ju dhe gjithë shoqëria juaj jeni mbledhur kundër Zotit” (Numrat 16:11)? Korahu u rebelua sepse e konsideroi shërbimin ndaj Zotit si një demokraci. Ai donte të kishte influencë. Kujtoni Krishtin, kreu i Kishës dëshiron ta udhëheqë Kishën me anë të Frymës së Tij, jo nëpërmjet forcës ose fuqisë, as sundimit të shumicës.

29. Dinjiteti – “Forca dhe dinjiteti janë veshja e saj dhe ajo i buzëqesh të ardhmes” (Fjalët e Urta 31:25). Një grua që është vërtet e dashur nga burri i saj dhe e aftë të zhvillojë të gjithë potencialin e saj të dhënë nga Perëndia, është një bekim i mahnitshëm për familjen e saj. Ky ishte qëllimi i Perëndisë kur krijoi Evën si një ndihmëse të përshtatshme për Adamin. Burrë, mëso si ta duash gruan tënde.

30. Dashuria sakrifikuese – “Ju, burra, t’i doni gratë tuaja, sikurse edhe Krishti ka dashur kishën dhe e ka dhënë veten e vet për të” (Efesianëve 5:25). Burra, më mirë të jemi të ndershëm dhe të rrëfejmë paaftësinë tonë për të përmbushur këtë urdher biblik. Prandaj, le të lejojmë që Krishti të jetojë jetën e Tij nëpërmjet nesh. Dashuria e tij sakrifikuese do t’i shndërrojë edhe martesat tona në parajsë.

31. Çlirimi është afër – “Kur këto gjëra të fillojnë të ndodhin, shikoni lart dhe ngrini kokat tuaja, shpengimi juaj është afër” (Luka 21:28). Ndërsa tensionet globale rriten dhe katastrofat natyrore janë në rritje, mos kini frikë se Mbretëria e Perëndisë është afër. Lutuni që të jeni gati të qëndroni përpara Birit të Njeriut kur Ai të kthehet.